



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVEKNDIM
Nr. Date 25.11.2021

**“PER MIRATIMIN E NJË TRANSFERIMI BUXHETOR PËR
INFRASTRUKTURËN KRITIKE, PËR MBROJTJEN CIVILE, “MIREMBAJTJE TE
SEGMENTIT RRUGOR, FSHATI KRIONER ”.**

Ne mbeshetjje te nenit 54, pika “dh”, te ligjit 139/2015 “Per Veteqeverisjes vendore”, Nenit 30, pika i, ligji 45/2019, “Per Mbrojtjen Civile”, ligjit nr.9936,dt.26.06.2008, “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar, ligjit nr.10296 date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.69 datë 22.12.2020 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe buxhetit të Bashkisë Dropull për vitin 2021”, në mbledhjen e datës 25.11.2021, me propozim te Kryetarit te Bashkise,

KESHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1.Miratimin e transferimit buxhetor, për infrastrukturën kritike, për mbrojtjen civile, “Mirembajtje te segmentit rrugor, fshati Krioner”, si më poshtë:

Të Pakësohet:

I-Gr.00.Tit.04980 .Kap.1.Art .609 per 860.060 lek

Të Shtohet:

I-Gr.00.Tit. 04520 .Kap.1. Art . 602 per 860.060 lek

2. Ngarkohet Drejtoria e Financës. Buxhetit dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi .

3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 ,pika 6 te ligjit nr.139/2015” Për Vetëqeverisjen Vendore”).

KRYETAR

Donika BAUÇI

Në mungesë dhe me porosi
N/Kryetar
Dhimitri Koça



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DROPULL

DREJTORIA E FINANCËS, BUXHETIT DHE MBROJTJES SOCIALE.

RELACION

PËR MIRATIMIN E NJË TRANSFERIMI BUXHETOR PËR INFRASTRUKTURËN KRITIKE, PËR MBROJTJEN CIVILE, “MIRËMBAJTJE TË SEGMENTIT RRUGOR, FSHATI KRIONER ”.

Në mbështetje të Nenit 30, pika i, ligji 45/2019 “Per Mbrojtjen Civile”, “Bashkitë mbajnë në gatishmëri sistemet e mbrojtjes nga zjarri, kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale, vendet e strehimit, si dhe mbledhin dhe administrojnë rezervat ushqimore për njerëzit dhe gjënë e gjallë”, si dhe nisur nga kërkesat e Kryetarit të Kryesisë së fshatit Krioner dhe Administratorit të Njesisë Administrative Dropull i Sipërm, në lidhje me gjëndjen e emergjencës pas rrëshqitjes së trupit të rrugës të fshatit Krioner, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Urban dhe Shërbimeve Publike, u krye vizita me ekip në terren, nga ku u konstatua nga afër se trupi i rrugës së fshatit Krioner në një gjatësi prej 32 ml, si pasojë e shirave të rëmbyeshëm, ka pësuar shmangie dhe rrëshqitje të dherave, duke bllokuar kalimin e mjeteve dhe aksesin e banorëve të fshatit në nevojat dhe shërbimet e tyre të përditshme. Ky rrjet rrugor konsiderohet nga ana jonë infrastrukturë kritike, pasi është i domosdoshëm për funksionimin ekonomik dhe social të komunitetit të fshatit Krioner. Prandaj u morr kjo masë strukture për të zvogëluar ose shmangur impaktin e mundshëm të reziqevdhe mundësinë ripërtëritëse të rrjetit rural në fjalë.

Në keto kushte nga ana e kësaj Drejtorie u kërkua ndërhyrja emergjente për mirëmbajtjen e këtij segmenti rrugor, që kishte rrëshqitur, sistemimin e skarpatës së dherave dhe të ujrave sipërfaqësorë, pasi periudha në vazhdim, muajt Nëntor- Mars, karakterizohet nga shira të mëdha dhe dalje të përrenjve dhe erozionit të vazhdueshëm. Ndërhyrja emergjente konsiston në marrjen e masave për të hapur një rrugë të re me një gjatësi 32 ml dhe gjeresi 3.0m, paralel me atë ekzistuese nga ana e sipërme e rruges ekzistuese. Hapjen e dy kanaleve paralel me këtë rrugë, njëri me gjatësi 35 ml që në pjesën e poshtme do të shtrohet një shtresë betoni dhe mbi të vendoset një tub me $d=315$ mm, i mbuluar me cakëll në thellësi 0.7-0.8 m, që do të shërbejë si drenazh për grumbullimin e ujrave nentoksore, të cikato do të hidhen në kanal tjetër., si dhe kanalit në krah të rruges me gjatësi 150ml deri tek urra. Ky kanal do të jetë i veshur me beton sipas projektit. Do behet germimi i skarpates anesore dhe rrafshimi i saj. Do të kryen punimet për grumbullimin e ujrave tek burimi sipër rruges dhe me kanal betoni do të dergohen me poshte për tek kanali i rruges. Do të behet mbushja e trupit të rruges me material të trashë me $t=40$ cm, si dhe një shtresë me material me të hollë nivelimi me $t=15$ cm. Rruga do të shtrohet me beton C16/20 me gjatësi 32 ml , gjeresi 3 m dhe me $t=15$ cm me zgare hekuri (15x15cm).

Nga ana e Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Mbrojtjes Sociale, referuar emergjencës në fjalë, u morrën masat për mbështetjen me fonde të këtij objekti për mirëmbajtjen e segmentit rrugor të cituar më lart. Bazuar në projekt-preventivin e përgatitur, grafikun e punimeve, relacionin teknik dhe në specifikimet teknike të hartuara,

Kërkojmë nga ana Juaj miratimin e transferimit buxhetor për infrastrukturën kritike, për mbrojtjen civile, “Mirëmbajtjen e segmentit rrugor, fshati Krioner”, që konsiston në

kalimin e shumës prej 860.060 lekë nga Programi 04980 (Fond Emergjence dhe Fond rezervë), në Programin 04520 (Rrugë Rurale). Bashkangjitur i gjithë dokumentacioni teknik justifikues.

Konceptoi: K.Lengo

Miratoi : TH.Pullà

KRYETARI I BASHKISE

Dhimitraq TOLI